

418.

A K T



PER THEMELIMIN E SHOQERISE ANONIME "BOLV - OIL" SH.A

Ky akt u nenshkrua me daten 09.10.2002, nga une aksioner Behar Cukaj, I biri I Myslymit, datlindja 1962 banuese ne Fier, qe me vullnet te plote e te lire, krijova shoqerine anonime "BOLV - OIL" Sh.A.

ME NENSHKRIMIN E AKTIT VENDOSA SI ME POSHTE:

Neni 1

Te krijojë shoqerine anonime me emertimin " BOLV - OIL" SH. A.
Shoqeria do te kete seline Lagjja Apollonia Fier.

Neni 2

Ne baze te legjislacionit shqiptar shoqeria eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas ligjit per shoqerite tregtare, nr.7638 date 19.11.1992, legjislacionit shqiptar qe rregullon kete veprimtari, statutit te shoqerise dhe kesaj kontrate qe eshte pjese e pandashme e tij.

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete nj ekoezgjatje prej mbi 10 vjet

O B J E K T I

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

-Tregeti me shumice i naftes dhe i nenprodukteve te saj.

-Tregeti te artikujve te ndryshem ,bujqesore, industriale, ushqimore, veshmbathje, veshje te ndryshme, mallra bujqesore, blektorale, makineri, pajisje, pjese kembimi, tregeti te materialeve te ndertimit ,detergjente, lende e pare ,elektroshtepijake, elektrike, elektronike dhe importi dhe eksporti I tyre.

-Hapje restoranteh, bar bufe, piceri hotele.

Hapje servisi, pika karburanti, autoshkolla etj,

-Transport mallrash e pasagjeresh brenda dhe jashte vendit.



KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2.000.000 leke me kontribut te aksionerit Behar Cukaj. Ai eshte i ndare ne 2000 aksione me vlere nominale 1000 leke per secilin dhe te numertuara nga 1 deri tek 2000.

Ne librin e llogarise te shoqerise krijohet fondi themeltar i aksionerit.

Neni 5

Shoqeria e fillon veprimtarine e saj pas regjistrimit ne regjistrin tregtar te gjykates se Shkalles se Pare Tirane dhe per veprimtarite per te cilat legjislacioni kerkon leje te vecanta pas nxjerrjes se tyre. Mbas regjistrimit person juridik shoqeria regjistrohete ne zyren tatimore ku pajiset me certificate regjistrimi. Fitimi i shoqerise pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe zbritjes se fondeve te detyruara do te ndahet ndermjet ortakeve perpjestimisht me kontributet e tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 6

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asambleja e aksionerve,
2. Keshilli mbikqyres.
3. Drejtori.

Neni 7

Keshilli mbikqyres i shoqerise do te perbehet nga tre antar dhe nga radhet e tij do te zgjidhet kryetari. Antaret e pare te keshillit mbikqyres dhe ekspertit kontabel i autorizuar caktohen per nje afat prej tre vjetesh.

Mbas perfundimit te afatit te antareve te pare te keshillit mbikqyres dhe ekspertit kontabel te autorizuar zgjedhja e tyre behet ne perputhje me kerkesat e ligjit per shoqerite tregtare.

Neni 8



 Anëtarët e pare të Keshillit mbikqyres do të caktohen në statut nga une themeluesi i shoqërisë.

Ata janë:

1. Asim Buzi 2. Vitori Muhaj 3. Myslym Cukaj

Ekspert kontabel i autorizuar u emërua z. Kastriot Hoxhaj.

Antaret e pare të Keshillit Mbikqyres dhe ekspertit i pare kontabel caktohen për një afat prej tre vjetësh.

Mbas përfundimit të afatit të antareve të pare të keshillit mbikqyres dhe ekspertit kontabel të autorizuar të caktuar në statut emerimi dhe zgjedhja e radhës e tyre bëhet në përputhje me ligjin.

Neni 9

Drejtor i përgjithshëm i shoqërisë u emërua aksioneri i vetëm z. Behar Cukaj

Ai emërohet për një periudhë tre vjeçare dhe mbas këtij afati mund të rrimërohet. Aktin e emerimit të tij e nënshkroi kryetari i keshillit mbikqyres.

Neni 10

Aksioneri i shoqërisë detyrohet të ruajë karakterin e fshehtë të dokumentacionit, të informatave, të njohurive dhe të përvojës së shkëmbyer ose të realizuar në kuadrin e shoqërisë dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur përhapjen e tyre qoftë edhe pjesërisht.

Aksioneri përgjigjet për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga shkelja e mundeshme e detyrimeve të mesipërme në qoftë se shkelja ka ndodhur nga një veprim i qëllimshëm ose nga pakujdesia.

Neni 11

Ky akt është i vleshëm nga dita e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar të gjykatës Tiranë. Prishja dhe likuidimi i shoqërisë bëhet në përputhje me statutin e shoqërisë që është pjesë perberëse e këtij akti duke zbatuar rigorozisht rregullat e percaktuara në ligjin për shoqëritë tregtare.

Neni 12





Çdo mosmarreveshje midis paleve kontraktuese do të zgjidhet në rrugën e mirëkuptimit në rast të kundërt palet do të drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane.


Neni 13

Për pasqyrimin e veprimtarisë së saj shoqëria do të pajiset me gjithë librat dhe dokumentacionin që kërkon ligji për shoqëritë anonime.

Ky akt u perpilua në katër kopje me fuqi të barabarta.

AKSIONER
Behar Cukaj

Behar Cukaj
[Signature]



[Signature]